



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 03.04.2024

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.1) të Rregullores për Prokurim Publik të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 28.03.2024, të parashtruar nga Operatori Ekonomik "INFINITT " SH.P.K. lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizimi, instalimi dhe servisimi me kamera, projektor, TV, fotoaparate, Sistem zërimi, ndriçim profesional", Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-24-1635-1-2-1, Nr. i brendshëm-632-24-014-121, nxjerr:

V E N D I M

1. Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik "INFINITT " SH.P.K e dt.15.03.2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizimi, instalimi dhe servisimi me kamera, projektor, TV, fotoaparate, Sistem zërimi, ndriçim profesional", Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-24-1635-1-2-1, Nr. i brendshëm-632-24-014-121, kundër DOSJES SË TENDERIT DHE NJOFTIMIT PËR KONTRATË, të publikuar me datë 29.02.2024, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.

2. Vërtetohet DOSJA E TENDERIT DHE NJOFTIMI PËR KONTRATË, i publikuar me datë: 29.02.2024 dhe e korrigjuar me dt.28.03.2024;

3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj me procedurat e prokurimit.

4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .

Arsyetim

Operatori Ekonomik "INFINITT" SH.P.K me dt.28.03.2024, ka parashtruar kërkesës për rishqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizimi, instalimi dhe servisimi me kamera, projektor, TV, fotoaparate, Sistem zërimi, ndriçim profesional", Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-24-1635-1-2-1, Nr. i brendshëm-632-24-014-121.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 03.04.2024, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pretendimet tuaja janë të njëjtat që i keni parashtruar me Kërkesën për rishqyrtim të dt.15.03.2024, dhe Autoriteti kontraktues(për këto dy pretendime) qëndron pranë përgjigjes që iu është kthyer me Vendimin e dt.20.03.2024, si vijon:

Pretendimi juaj i parë nuk qëndron, sepse ky është një projekt i planifikuar dhe konstatohet se të gjitha aktivitetet janë të së njëjtës fushë;

Pretendimi juaj i dytë nuk qëndron, sepse projekti ka të bëjë me furnizim dhe instalim të pajisjeve teknologjike, për këtë arsye kërkojmë që stafi profesional të jetë ashtu siç është kërkuar në FDT-ë;

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . **Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.**

Faton Gutaj

Menaxher i Zyrës së Prokurimit

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit të Komunës;
Te gjitha palëve të interesuara;

